



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3381/ 11 prot.

Datë 03/02/2026

V E N D I M

Nr. 196/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03/02/2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 107/2026, datë 20.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK me NIPT: J81527001Q, dhe me adresë: Rruga “Sulejman Delvina” Pallati “Fati”, Shk.1, Ap.19, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit

të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 107/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPower Energy SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALBAVIA SHPK & AlbPower Energy SHPK”, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 477/1 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3381/8 prot, datë 29.01.2026, autoriteti kontraktor KESH sh.a (*Korporata Elektroenergjitike Shqiptare*), lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 107/2026, datë 20.01.2026, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke kualifikuar ofertën e bashkimit të opeatorëve ekonomikë “*ALBAVIA SHPK & AlbPower Energy SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “*Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare*”, me fond limit 40,000,000 (*Dyzet milion*) Lekë pa TVSH ose 413,137 (*Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë*) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (*Korporata Elektroenergjitike Shqiptare*).

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 477/1 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3381/8 prot, datë 29.01.2026, autoriteti kontraktor KESH sh.a (*Korporata Elektroenergjitike Shqiptare*), lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 107/2026, datë 20.01.2026, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke kualifikuar ofertën e bashkimit të opeatorëve ekonomikë “*ALBAVIA SHPK & AlbPower Energy SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “*Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare*”, me fond limit 40,000,000 (*Dyzet milion*) Lekë pa TVSH ose 413,137 (*Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë*) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (*Korporata Elektroenergjitike Shqiptare*).

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe verifikimeve të bëra në systemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke kualifikuar ofertën e bashkimit të opeatorëve ekonomikë “*ALBAVIA SHPK & AlbPower Energy SHPK*” në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 107/2026 datë 20.01.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e*

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-62799-09-26-2025, me objekt: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”, me fond limit 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

